LIGJ
Nr. 96/2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 49, "Shkallët e reduktuara", pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

"6. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, është 6 për qind.

7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 6 për qind deri në datën 31 dhjetor 2021. Nga data 1 janar 2022 shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar që aplikohet për këtë furnizim është 10 për qind.

8. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e librave të çdo lloji, është 6 për qind.".

Neni 2

Në nenin 51, "Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm", pas shkronjës "m" shtohen shkronjat "n", "nj" dhe "o" me këtë përmbajtje:

"n) furnizimi i makinave bujqësore. Lista e makinave bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;

nj) furnizimi i inputeve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuar në kodet 2937 të NKM-së. Lista e kategorive të imputeve bujqësore përcaktohet vendim të Këshillit të Ministrave;

o) furnizimi i shërbimeve veterinare, me përjashtim të shërbimeve veterinare për kafshët shtëpiake.".

Neni 3

Në nenin 53, "Përjashtime për disa veprimtari të tjera", në shkronjën "j" fjalët "dhe i librave", "dhe nga media elektronike" hiqen.

Neni 4

Në nenin 56, "Përjashtime të veçanta në import", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 41 shfuqizohet.

2. Pas pikës 41 shtohet pika 42 me këtë përmbajtje:

"42. Importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, me përjashtim të lëndëve me përdorim të dyfishtë, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për

barnat. Lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 57, “Eksportet”, shkronja “ç” riformulohet si më poshtë:

“ç) furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t’u rieksportuar, nga personat e tatueshem të autorizuar dhe nënkontraktorët e tyre, mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv.

Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm, për zbatimin e shkronjës “ç””.

Neni 6

Në nenin 64, “Veprime që lidhen me regjimet doganore e të tjera të ngjashme”, në shkronjën “c”, pas fjalëve “nën regjimin e përpunimit aktiv” shtohen fjalët “nga mbajtësi i autorizimit dhe nënkontraktorët e tij”.

Neni 7

Në nenin 148, “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, fjalët “20 për qind” zëvendësohen me fjalët “6 për qind”.

Neni 8

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.12.2018